



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Sintaksë e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore: 20 leksione, 20 seminare/ushtime

Viti / Semestri : Viti II /semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Lënda synon t'i japë studentit elementet e nevojshme për të formuluar dhe shprehur saktë mendimet në gjuhën frënge, sipas rregullave të kësaj gjuhe

Objektivat specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

1. Të dijë të zbërthejë një fjali në elementet përbërës
2. Të dijë të zbërthejë një fjali të përbërë në fjali të thjeshta dhe të dallojë marrëdhëniet ndërmjet tyre
3. Të jetë i aftë të formulojë fjali dhe periudha sipas rregullave të gjuhës frënge.

Në përfundim të këtij moduli studentët do të jenë të aftë :

Të përdorin në mënyrë korrekte materialin gjuhësor të zotëruar, duke formuluar fjali të sakta e logjike.